

## Член 11

Овој закон влегува во сила со денот на објавување-то во „Службен весник на Република Северна Македонија“.

## L I G J

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT  
PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE

## Neni 1

Në Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18, 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 104/19), në nenin 39-zh pas paragrafit (2) shtohen dy paragrafë të rinj (3) dhe (4), si vijojnë:

“(3) Shuma e shtesës për arsim nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni harmonizohet me rritjen e harxhimeve të jetës për vitin paraprak, të shpallura nga Enti Shtetëror i Statistikës, në janar për vitin rrjedhës.

(4) Në rast kur nuk ka rritje të harxhimeve të jetës për vitin paraprak, nuk kryhet harmonizim i shumës së shtesës për arsim nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.“

Paragrafi (3) bëhet paragraf (5).

## Neni 2

Në nenin 127-a pas fjalëve: “licencë për drejtor” shtohen fjalët: “si dhe të posedojë një nga certifikatat e njohura ndërkombëtarisht ose vërtetim për njohjen aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet TOEFEL IBT – së paku 74 pikë, IELTS (IELTS) – së paku 6 pikë, ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku nivelin A2 (A2), FCE (FCE) (Cambridge English: First) – i dhënë, BULATS (BULATS) – së paku 60 pikë, përkatësisht APTIS (APTIS) – së paku niveli B2 (B2).“.

## Neni 3

Në nenin 142 paragrafi (11) ndryshohet si vijon:

“Nëse me sukses e jep provimin profesional nga paragrafi (10) i këtij neni, praktikanti pas sigurimit të mjeteve financiare avancohet në nivelin vijues.“.

## Neni 4

Neni 142-a ndryshohet si vijon:

„Neni 142-a

Drejtori i institucionit publik për fëmijë, përgatit plan vjetor për punësim për vitin vijues, në pajtim me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik.“.

## Neni 5

Në nenin 143 paragrafi (8) pas fjalëve: “në shkallë të dytë” shtohen fjalët: “në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të vendimit nga paragrafi (17) i këtij neni.“.

## Neni 6

Në nenin 166-z fjala "komunat" zëvendësohet me fjalën "themeluesit“.

## Neni 7

Procedurat për kërkesat për realizimin e të drejtës për ndihmë të njëhershme në para për të sapolindur me dokumentacionin e nevojshëm për fëmijë të lindur deri në ditën e hyrjes në fuqi të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 104/19) do të përfundojnë në pajtim me dispozitat në fuqi deri në ditën e hyrjes në fuqi të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 104/19).

## Neni 8

Procedurat e filluara për kërkesat për realizimin, përkatësisht vazhdimin e të drejtës së participimit të parashtruara deri në ditën e hyrjes në fuqi të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 104/19) e të cilat nuk janë zgjidhur deri në ditën e hyrjes së të njëjtit në fuqi, do të përfundojnë në pajtim me dispozitat që kanë vlejtur deri në ditën e hyrjes së të njëjtit në fuqi.

## Neni 9

Të punësuarit kujdestarë të hasur në vend pune në pajtim me nenin 98 paragrafi 1 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 104/19) do të mund edhe të avancohen në institucion publik për fëmijë në kushte të njëjta si dhe të punësuarit tjerë kujdestarë, të njëjtit mund ta përtërijnë/vazhdojnë licencën përkatëse të marrë për punë.

Personat me arsim të përfunduar të mesëm katërvjeçar, të cilët kanë marrë licencë të vlefshme për kujdestar deri në ditën e hyrjes në fuqi të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 104/19) mund të punësohen dhe të avancohen në institucion publik për fëmijë në kushte të njëjta si dhe personat nga neni 44 paragrafi (10) alinetë 2, 3 dhe 4 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 104/19), e mund të punësohen edhe në institucion privat për fëmijë në vend pune kujdestar në kushte të njëjta si dhe personat nga neni 62 paragrafi (1) pika 4. të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 104/19). Personat e njëjtë mund ta përtërijnë/vazhdojnë licencën përkatëse për punë në pajtim me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 104/19).

## Neni 10

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve.

## Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.